



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 14.2.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: anëtarët e Komisionit për Komunitete, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.02.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoça e Madhe bashkërisht me Komisionin për Komunitete,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.2.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Hoçën

Kryetari Nait Hasani përshëndeti dhe ju dëshiroj mirëseardhje anëtarëve të komisionit për komunitete duke sqaruar arsyen pse është sugjeruar takimi i përbashkët me këtë komision. Pasi që janë miratuar amendamentet në komisionin funksional, vazhdoi, procedimi ka vazhduar në komisionet e përhershme ku janë kundërshtuar (komunitetet) amendamentet e këtij komisioni, ndaj është pa si e arsyeshme të mbahet një mbledhje e përbashkët. Ai sugjeroi mënyrën e punës së shqyrtimit të amendamenteve një nga një, në mënyrë që të ketë hapësirë për komente dhe kundërshtime eventuale. **Goran Marinković** (kryetar i komisionit për komunitete) përshëndeti iniciativën e kryetarit të komisionit funksional për takim të përbashkët ngase kemi të bëjmë me një projektligj që është i ndjeshëm për komunitetin serb, por i rëndësishëm për të gjithë. Ky projektligj siguron mbrojtjen e monumenteve historike sipas Pakos së Ahtisarit (neni 5 dhe 4) për të siguruar kulturën fetare. Amendamentet e komisionit funksional nuk janë arsyetuar, ndaj ato janë kundërshtuar si të tilla dhe shprejoi se arsyetimi do të pasoi në këtë takim të përbashkët.

Petar Miletić ishte i mendimit se amendamentet në fjalë ndryshojnë esencën e projektit të propozuar, megjithatë shprehu disponimin të dëgjohen argumentet, pastaj komisioni për komunitete në një takim të veçantë do të vendos për procedimin e mëtejshëm sipas këtyre amendamenteve. Ai sugjeroi që të arsyetohen amendamentet në tërësi, ngase shqyrtimi një nga një është droja se do të dërgoj këtë takim në “qorrsoak”. **Nait Hasani** u pajtua fillimisht për shqyrtimin një nga një të amendamenteve sepse më lehtë zbulohen kundërshtimet, megjithatë pasi që zyrtarët e komisionit për komunitete kërkuar, u pajtua që në këtë takim të epen sqarimet dhe argumentet. **Liburn Aliu** tha se është interesi i komisionit funksional të gjej gabimet e veta, ngase fundi fundit edhe ky komision është interesuar të mos shkelen drejtat e komuniteteve. **Petar Miletić** tha se komisioni për komunitete është pajtuar me propozimin e Qeverisë, ndaj shprehu dyshimin se polemikat do të sjellin rezultate pozitive, gjithashtu ceku se ICO ka zbatuar Pakon e Ahtisarit, për çka në fund ai tha se do të kërkojnë vendimin e ICO për ndryshime eventuale të qëndrimeve apo të Pakos në fjalë. **Liburn Aliu** tha se Qeveria sjellë propozime ndërsa Kuvendi ka drejtën e trajtimit të propozimeve, nuk do të thotë se një propozim i Qeverisë është definitive dhe i mirë. Ai kërkoj nga komisioni përkatës të gjenden pikat kyçe të amendamenteve sipas të cilave cenohen drejtat e komuniteteve, në mënyrë që pastaj ky komision të ndryshoj, pse jo. **Salih Morina** sqaroi se ndryshimet apo më saktë amendamentet, janë hartuar në praninë e MMPH dhe ICO në mbledhjet e komisionit, të cilat shumica janë harmonizuar me komisionin. Edhe ai kërkoj të cekën nenet të cilat cenojnë drejtat e komuniteteve. **Lumnije Morina** elaboroi shkurtimisht për punën e komisionit për komunitete ku janë votuar tri lloj amendamente të propozuara në komisionin funksional, dhe asgjë nuk ka pasur lidhur me paragjykimet, amendamentet janë votuar por kundër interesave të askujt, sidomos të komuniteteve. **Goran Marinković** u pajtua me zj. Lumnije por jo edhe të shkohet në mënyrën siç ka ndodhur p.sh. me projektligjin për banesa.

Në vazhdim **Nait Hasani** lexoi amendamentet një nga një. Për amendamentin e parë zyrtarët e komuniteteve thanë se nuk mbron kulturën fetare si duhet. Reagoi **Liburn Aliu** dhe konstatoi se trashëgimia kulturore përfshinë edhe kulturën fetare. Komisioni për këtë qëllim dhe për siguri më të madhe, gjatë mbledhjeve në komision ka ftuar ekspertin Gjejlane Hoxha dhe ka vërtetuar se nuk ka trashëgimi fetare. **Petar Miletić** tha se megjithatë në amendamentin 2 përmendet edhe “fetare” ndaj konstatoi se polemikat mund të vazhdojnë. “Ne përkrahim Qeverinë, asgjë tjetër”, përfundoi ai. **Liburn Aliu** tha se në këtë amendament qëndron ajo por është gabim, si pasoj nga Pakoja e Ahtisarit.

Në vazhdim **Nait Hasani** vazhdoi me arsyetimin e çdo amendamenti veç e veç, ndërkaq në fund falënderoi për bashkëpunim dhe konstatoi se komisioni është në dijeni që janë tejkalluar amendamentet e parapara për një projektligj në këtë rast (mbi 50% të neneve të projektit), mirëpo komisioni funksional ka konstatuar se vetëm me këto ndryshime mund të procedohet ky projektligj më tutje.

Goran Marinković gjithashtu falënderoi dhe konstatoi shumë falënderues gjestin e kryetarit të komisionit për të ftuar këtë takim të përbashkët. Ai shtoi se komisioni për komunitete me siguri do të shqyrtoi edhe një herë amendamentet në fjalë të komisionit funksional, ngase në takimin e sotëm u vërtetua se mund të gjendet gjuha e përbashkët për disa amendamente, përveç për disa (p.sh. Amendamenti 4 është i pa qëndrueshëm për komunitetet).

Petar Miletić gjithashtu falënderoi për gjestin e mirë të kryetarit të komisionit funksional z. Nait Hasani, dhe tha se komunitetet kanë kundërshtuar amendamentet e këtij komisioni në pako, mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk do të shqyrtohen prapë, sidomos amendamentet 1, 2, 3 etj të cilat mund të mbështeten, mirëpo jo të gjitha. Komisioni për komunitete përveç që do ti shqyrtoi sërish amendamentet, do të kryej edhe konsultimet tjera të duhura.

4. Të ndryshme

Nait Hasani sipas kërkesës së disa anëtarëve të komisionit sugjeroi të shtyhet shqyrtimi i sotëm për “Mbeturina” për të hënë kur do të shqyrtohen edhe çështje tjera nëse përgatiten deri atëherë (projektligji për Prizrenin dhe për Agjencinë).

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani